



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë/Ministarstvo Zdravstva/Ministry of Health

30 Prill 2020
Nr. Xx/2020

Bazuar në nenin 132 të Ligjit Nr. 05/L -031 - Për procedurën e përgjithshme administrative, nenin 38 të Ligjit 04/L-190- Për Produkte dhe Pajisje medicinale, nenin 17 të Udhëzimit Administrativ 02/2019 - Për rregullimin e çmimeve të produkteve dhe pajisjeve medicinale, Vendimin nr. protokoll 35/2019, datë 27.06.2019, me rastin e shqyrtimit të kërkesës me Nr. 47, të datës 26.03.2020, nga Kompania **Rona Pharm**, me seli në Prishtinë, me adresë: Lagjja Kalabria, me person përgjegjës **Argjend Taraneshi**, të ushtruar kundrejt vendimit të komisionit për çmime të publikuar më 23 Mars në webfaqen e MSH, Komisioni për çmime, në takimin e mbajtur me datë 30.04.2020, nxjerr këtë:

VENDIM

Aprovohet pjesërisht kërkesa për rishqyrtim të çmimeve e parashtruar nga Kompania Rona Pharm, me seli në Prishtinë, me adresë: Lagjja Kalabria.

Çmimet finale janë si vijon:

DEGASTROL,lansoprazole,CAPSULE,30mg,14 cap,	1.27
DEMEPRAZOL,omeprazole,CAPSULE,20mg,14 cap	0.70
LETRASAN,letrozole,FILM COATED TABLET,2.5mg,30 film tab	6.00

Arsyetimi

Ministria e Shëndetësisë, përkatësisht komisioni për çmime bazuar në dispozitat e Udhëzimit Administrativ 02/2019 për rregullimin e çmimeve të produkteve medicinale pas zhvillimit të procedurave të parapara me aplikacionet, dhe evalumin e tyre më datë 23 Mars 2020 ka publikuar vendimin për përcaktimin e çmimeve të produkteve medicinale të cilat posedojnë autorizim për marketing pranë AKPPM. Bazuar në paragrafin 1 të nenit 17 kundër vendimit të komisionit pala ka të drejtë të parashtrojë kërkesë për rishqyrtim në komisionin për çmime në afat prej 8 ditësh nga dita e publikimit të vendimeve.

Kompania Rona Pharm, me seli në Prishtinë, me adresë: Lagjia Kalabria, bazuar në paragrafin 1 të nenit 17 të UA 02/2019, brenda afatit ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim të çmimeve të produkteve medicinale si vijon

1. DEGASTROL,lansoprazole,CAPSULE,30mg,14 cap, për të cilin ka aplikuar për çmimin 1.27
2. DEMEPRAZOL,omeprazole,CAPSULE,20mg,14 cap, për të cilin ka aplikuar për çmimin 0.70
3. LETRASAN,letrozole,FILM COATED TABLET,2.5mg,30 film tab, për të cilin ka aplikuar për çmimin 10.00

Komisioni duke u bazuar në dispozitat e udhëzimit administrativ përkatësisht në paragrafin 2 të nenit 17 të UA 02/2019 ka përcaktuar si vijon:

MAH: DEVA HOLDING A.S, - TURKEY

Emri i produktit	INN	Forma farmaceutike	Fortesia	Madhesia e paketimit	Cmimi i deklaruar	Cmimi në € në vendet referente/o rigjinës	Çmimi final në Euro	Komenti nga komisioni
DEGASTROL	lansoprazole	CAPSULE	30mg	14 cap	1.27	MK- 1.79	1.27	Aprovohet çmimi i deklaruar. Cmimi është vetëm në një vend referent dhe është më i lartë se cmimi i deklaruar.
DEMEPRAZOL	omeprazole	CAPSULE	20mg	14 cap	0.70	AI - 4.27 MK- 0.75	0.70	Aprovohet cmimi i deklaruar. Cmimi i deklaruar është me i ulët krahasuar me çmimet të vendeve referente.
LETRASAN	letrozole	FILM COATED TABLET	2.5mg	30 film tab	10.00	AI - 6.00 MK- 25.12	6.00	Cmimi final është përzgjedhur në bazë të çmimeve të vendeve referente duke hequr çmimin e Maqedonise si çmim i lartë.

Nga sa u tha u vendos si në dispozit të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Pala ka të drejtë ankese 15 ditë kalendarike pas shpalljes së kësaj përgjigjeje në Bordin për Ankesa për çmime të produkteve medicinale në Ministrinë e Shëndetësisë.

Komisioni për çmime:

1. Naim Bardiqi MSH kryetar _____
2. Selvete Shuleta AKPPM anëtare _____
3. Etrit Tetova AKK anëtar _____
4. Amir Keka FSSH anëtar _____
5. Shkumbin Jusufi OFK anëtar _____
6. Dardan Nallbani MTI anëtar _____
7. Blerta Kika MF anëtare _____

Vendimi i dërgohet:

Palës,

Departamenti farmaceutik,

Arkivës.